



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 843/ 2 prot.,

Datë 20.04.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-56894-01-25-2023, me objekt “*Blerje materiale pastrimi*”, me fond limit 39,999,986 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK
Adresa: Rruga “Fatmir Haxhiu”, Pall. 2, Shk. 10, Ap. 76,
Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.
Adresa: Rruga “5 Maji”, Tiranë.

Në datën 19.04.2023 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2023/3036, dhe nr. 843/2023 prot, datë 19.04.2023 e operatorit ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK për procedurën e “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-56894-01-25-2023, me objekt “*Blerje materiale pastrimi*”, me fond limit 39,999,986 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Pastrime Silvio*” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Pastrime Silvio” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 843 prot., datë 19.04.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

Produktet nr.23 dhe 24 nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 20.04.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova